



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

Janar-shtator 2014

**RAPORT I DORËZUAR TEK BASHKIMI EVROPIAN/SHËRBIMI EVROPIAN PËR VEPRIM
TË JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 10 tetor 2014

Shënim: Versioni origjinal i këtij Raporti është në gjuhën angleze / shih linkun http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_Implementation_of_Brussels_Agreements_101014.pdf

PARATHËNIE

Dialogu në Bruksel në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian ka prodhuar rezultate të rëndësishme gjatë gati katër viteve. I filluar si një dialog teknik në vitin 2011, dialogu në Bruksel është avancuar në fushëveprim dhe rëndësi me qëllimin e normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve që nga vjeshta e vitit 2012. Unë besoj se qëllimet kryesore të këtij dialogu të tilla si përmirësimi i jetës së qytetarëve, vendosja e marrëdhënieve paqësore ndër fqinjësore midis të dy shteteve, duke siguruar integrimin evropian për të dyja vendet, si dhe duke ndihmuar forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon janë në rrugë të mirë për t'u arritur.

Pas gati katër viteve të këtij procesi intensiv paqësorë, si dhe duke iu falënderuar lehtësimit konsekuent nga ana e BE-së dhe mbështetjes së plotë nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve me një të kaluar armiqësore janë duke u transformuar në një model evropian të bashkëpunimit. Në të njëjtën kohë, normalizimi i gjendjes në pjesën veriore të Kosovës po ecën përpara përmes procesit të integritit të qytetarëve serbë në institucionet e Kosovës dhe shpërbërjes së strukturave paralele serbe, duke i dhënë fund përzierjes së Serbisë në punët e brendshme të Kosovës.

Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, i zhvilluar midis të kryeministrave të të dyja shteteve dhe i lehtësuar nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë Catherine Ashton, që nga tetori i vitit 2012 rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve mes dy shteteve më 19 prill 2013. Që nga atëherë, Dialogu i Brukselit është duke përparuar në dy nivele: në arritjen e marrëveshjeve për zbatim/planeve të veprimit dhe në zbatimin praktik në terren të çështjeve të mbuluara me Marrëveshje.

Kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme, sepse është hera e parë që Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje politike/paqësore pas më shumë se dy dekadash të marrëdhënieve armiqësore, duke përfshirë okupimin, luftën dhe gjenocidin e Serbisë kundër Kosovës (1989-1999) dhe luftën për pavarësi të popullit të Kosovës, që mori fund në sajë të ndërhyrjes së SHBA-së dhe NATO-s në vitin 1999 dhe duke e vënë Kosovën nën protektoratin e OKB-së dhe NATO-s. Megjithatë, Serbia ka vazhduar të përzihet në çështjet e brendshme të Kosovës, veçanërisht duke u përpjekur që të ruaj kontrollin në pjesën veriore të vendit tonë (e njohur për minierat e pasura dhe burimet e ujit) me

krijimin e strukturave paralele ilegale serbe. Edhe pas pavarësisë së Kosovës më 2008, e cila është legjitimuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në vitin 2010, Serbia ka vazhduar ndërhyrjen e saj në Kosovë. Një proces i ri i paqes u bë i domosdoshëm për hir të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe paqes dhe stabilitetit rajonal, kështu që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së i bëri thirrje të dyja vendeve që të angazhohen në një dialog përmes rezolutës së miratuar më 9 shtator 2010, ku Bashkimi Evropian ishte ftuar që të luaj rol in e një lehtësuesi.

Në fazat e mëhershme, kanë qenë dy përpjekje të mëdha për të arritur paqen dhe marrëdhëniet paqësore midis dy vendeve: bisedimet paqësore në Konferencën e Rambujesë në vitin 1999 dhe bisedimet për statusin e pavarësisë së Kosovës në Vjenë (2006-2007). Të dy proceset dështuan për shkak të faktit se Serbia dështoi të nënshkruajë marrëveshjen edhe pse ka qenë pjesë e bisedimeve në të dy rastet. Në këtë kontekst, marrëveshjet e tanishme të arritura përmes dialogut (teknik dhe politik) janë një zhvillim historik për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Marrëveshja për Normalizimin e marrëdhënieve ofron një mundësi për të mbyllur kapitullin e konflikteve dhe të hapë kapitullin e paqes në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, dhe madje edhe në mes të dy kombeve, shqiptarëve dhe serbëve.

Dialogu për Normalizimin e Marrëdhënieve është paraprirë dhe mundësuar nga Dialogu Teknik. Dialogu Teknik mes Kosovës dhe Serbisë u zhvillua më 2011-2012, i lehtësuar nga BE-ja dhe me praninë e SHBA-së në tryezën e negociatave. Ai rezultoi me shtatë marrëveshje të arritura. Në fakt, marrëveshjet e para të arritura dhe të nënshkruara ndonjëherë në mes të Kosovës dhe Serbisë rezultuan nga ky dialogu teknik dhe çështjet e zgjidhura përfshijnë: lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, tregtinë e lirë, menaxhimin e integruar të kufirit ndërshtetëror, eliminimin e pengesave për bashkëpunim rajonal, kthimin në Kosovë të dokumenteve kadastrale dhe të gjendjes civile të marra nga Serbia gjatë luftës, dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare.

Dialogu teknik, ndërsa prodhoi marrëveshjet e para konkrete mbi çështjet e përmendura më lart, ai gjithashtu ndihmoi në hapjen e rrugës për bisedime politike mbi normalizimin e marrëdhënieve.

Të dy dialogët, teknik dhe politik, janë ballafaquar me skepticizëm dhe refuzim të madh nga ana e qytetarëve. Për qytetarët e Kosovës nuk ishte e pranueshme që të bisedohet me ish-armikun, Serbinë, para kërkim faljes për gjenocid dhe para njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Ishte mjaft interesante se njerëzit kundërshtonin më shumë dialogun

teknik se sa dialogun e normalizimit, ndoshta për shkak se ishte hera e parë që diskutohej me Serbinë pas pavarësisë së Kosovës dhe duke pasur parasysh se në dy proceset e mëparshme të paqes, në Rambuje dhe Vjenë, Serbia refuzoi marrëveshjet.

Megjithatë, qëndrimi ynë si udhëheqje ishte i qartë se derisa e kaluara nuk mund të harrohet, ajo nuk duhet të jetë pengesë në rrugën tonë për të çuar përpara vizionin tonë për Kosovën si një shtet euro-atlantik. Ne mbesim të përkushtuar në vizionin tonë për Kosovën si një shtet sovran dhe i pavarur i bazuar në vlerat themelore të demokracisë, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut - një shtet i respektuar dhe i njohur ndërkombëtarisht dhe një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon - i realizuar mes tjerash përmes marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal. Ne besojmë fuqimisht se reformat euro-atlantike në vazhdimësi të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës dhe një qasje shumë e matur dhe konstruktive në dialogun e Brukselit janë duke e sjellë Kosovën më afër BE-së, NATO-s, OKB-së dhe institucioneve të tjera të rëndësishme, derisa Kosova tashmë e ka parafuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE-në.

Duke qenë Kryenegociatore e Republikës së Kosovës në dialogun teknik me Serbinë për gati dy vjet, pastaj anëtare e Delegacionit të Republikës së Kosovës në Dialogun për Normalizim i kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi, për të vazhduar më tej si udhëheqëse e Delegacionit të Kosovës në Dialogun e Brukselit për zbatim, mund të them se kjo nuk ishte aspak një punë e lehtë, përkundër përvojës sime nga e kaluara, veçanërisht në Konferencën e Paqes së Rambujesë. Megjithatë, kam besuar se ishte gjëja e drejtë për të bërë. E dija se ky nuk ishte një mision i popullarizuar, por në thelb ishte mision paqësor dhe largpamës; prandaj unë isha e sigurt se kur të fillojë zbatimi konkret i marrëveshjeve, njerëzit ngadalë do të kuptojnë se kjo ishte për të mirën e tyre. Për më tepër, rezultatet e dialogut të Brukselit avancuan rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe integritit euro-atlantik dhe kjo është një trashëgimi tjetër që ne po e lëmë për gjeneratat e ardhshme të Kosovës.

Këtë parathënie e kam shkruar si një përmbledhje e të gjithë procesit të dialogut të Brukselit sepse kam dashur të nxjerrë në pah rëndësinë unike të dialogut paqësor të Brukselit. Ky dialog është i rëndësishëm jo vetëm për perspektivat evropiane të dy shteteve dhe paqes dhe stabilitetit në rajon, por edhe për përpjekjet e ardhshme të Bashkimit Evropian për paqe në rajon që duket se janë të domosdoshme në angazhimet për përshpejtimin e integritit evropian për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Po e shfrytëzoj këtë rast që të shprehë vlerësimet e mija të larta për përpjekjet e jashtëzakonshme të PL-së Catherine Ashton e cila pati sukses që ti hap rrugë

marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes Kosovës dhe Serbisë. Falënderimi im i veçantë i shkon të gjithë ekipit të saj të cilët punuan palodhshëm dhe me durim dhe do të punojnë për këtë projekt të rëndësishëm të paqes.

Dua ta theksoj angazhimin e shquar të Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha institucioneve të tjera të Kosovës, kryeministrin Hashim Thaçi dhe të gjithë kolegët e mi ministra për misionin sfidues në dialogun e Brukselit. Mirënjohja ime e veçantë shkon për të gjithë ekipin tim që ka qenë i përkushtuar dhe kompetent në gjithë punën e bërë gjatë këtyre viteve në Dialogun e Brukselit.

Si përfundim më lejoni të them se Marrëveshja për Normalizimin e marrëdhënieve është një hap historik për arsye të rëndësishme që ka dhe të cilën u përpoqa ta elaboroj shkurtimisht më lartë. Megjithatë, unë besoj fuqishëm se marrëveshja e vërtetë historike do të jetë ajo që do të përfundojë me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, përkatësisht njohjen e realitetit të ri politik në Ballkan pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe lindjes së shtatë shteteve të reja.

Sinqerisht,



Edita Tahiri

Zëvendës kryeministre

Udhëheqëse e Delegacionit të Republikës

së Kosovës në Dialogun e Brukselit për Implementim

Përmbajtja

Parathënie	2
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Funksionimi i katër komunave veriore të Kosovës	1
2. Siguria	13
3. Drejtësia	14
4. Ligji i amnistisë	14
5. Mbledhja e të hyrave nga doganat	15
6. Fondi për zhvillim	15
7. Zyrat e ndërlidhëse	16
8. Asociacioni	17
9. Menaxhimi i Integruar i Kufirit (IBM)	18
10. Liria e lëvizjes	18
10.1. Tensionet me barrikadat mbi urën e lumit Ibër në Mitrovicë	19
11. Tregtia e lirë	21
12. Bashkëpunimi rajonal	21
13. Energjia	22
14. Telekomunikacioni	23
15. Regjistri civil	23
16. Kadastri	24
17. Diplomat	24
18. Sigurimi i automjeteve	25
Përfundim	27
Lista e shkurtesave	28

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet vlerësimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin dhe sfidat në zbatimin e Marrëveshjeve të Dialogut të Brukselit për periudhën janar-shtator 2014. Raporti shqyrton të gjitha marrëveshjet e Brukselit të arritura në Dialogun për normalizimin e marrëdhënieve dhe dialogun teknik mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë periudhës së raportimit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera ishin plotësisht të përkushtuara në dialogun e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, përkundër faktit se ky ka qenë një vit i zgjedhjeve nacionale për ne. Ne kemi qenë veçanërisht të fokusuar në zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të të gjitha marrëveshjeve të Brukselit, sepse besojmë se zbatimi është qenësor për suksesin e këtij dialogu dhe për progresin për të cilin synon.

Në fakt, në pranverë të këtij viti janë mbajtur po ashtu zgjedhjet nacionale edhe në Serbi. Si pasojë, agjendat zgjedhore të të dyja vendeve kanë ngadalësuar dinamikën e dialogut, por ne besojmë se një arsye esenciale për zvarritjet ishte mungesa e vullnetit politik të Serbisë për të përmbushur obligimet e zbatimit apo madje duke paraqitur edhe pengesa.

Në nivelin politik, të kryeministrave dhe PL Ashton, janë mbajtur vetëm disa takime (në janar, mars dhe prill), derisa në nivelin e zbatimit, negociatat vazhduan gjatë gjithë periudhës raportuese përveç periudhave zgjedhore. Kështu, më shumë rezultate janë arritur në procesin e zbatimit se sa në zgjidhjen e dallimeve të mbetura sa i përket planeve të zbatimit, duke përfshirë çështjet e drejtësisë dhe çështjet e sigurisë për pjesën e shpërbërjes së të ashtu quajturave "struktura serbe të mbrojtjes civile" dhe në ndërtimin e planit për krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Ka pasur përparime të dukshme në funksionimin ligjor dhe integrimin e katër komunave veriore në institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve të suksesshme lokale në nëntor 2013, në përputhje me ligjin e Kosovës dhe marrëveshjen e Brukselit. Pas zgjedhjeve, autoritetet e zgjedhura vendore të katër komunave veriore hynë në një proces të qeverisjes ligjore dhe demokratike, të pasuar nga inaugurimi zyrtar dhe miratimi i statuteve komunale, në pajtim me ligjin e Kosovës siç është paraparë në Marrëveshjen e Brukselit. Ekziston një bashkëpunim në rritje në mes të këtyre autoriteteve lokale dhe të autoriteteve qendrore duke shtyrë përpara agjendën për një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës.

Kemi kënaqësinë të theksojmë se integrimi i qytetarëve tanë serbë nga komunat veriore në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës është në rrugë të mirë, ndërkohë që Qeveria e Kosovës vazhdon konsolidimin e sovranitetit, demokracisë, sundimit të ligjit dhe të perspektivës ekonomike në tërë Kosovën për të mirën e të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu.

Ngjashëm, progres i mirë është bërë në çështjet e sigurisë. Mbyllja e strukturave paralele të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme në pjesën veriore të vendit tonë dhe integrimi i plotë i personelit serb në Policinë e Kosovës, duke përfshirë procesin e gradimit të tyre në bazë të ligjeve të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit, ofron cilësi më të mirë të sigurisë për të gjithë.

Përparim është bërë edhe në avancimin e zbatimit të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit (IBM), ku është arritur dhe nënshkruar marrëveshja për ndërtesa të përhershme për gjashtë pikëkalime kufitare të IBM (shtator 2014).

Është shënuar përparim i madh në çështjet e energjisë, ku më në fund plani i zbatimit/veprimit për energji është dakorduar dhe nënshkruar së bashku me marrëveshjen Inter-TSO dhe marrëveshjen operacionale. E konsiderojmë këtë një përparim të madh, sepse pas pothuajse katër vjet të negociatave për çështjet e energjisë, më në fund janë arritur marrëveshja dhe plani i zbatimit, respektivisht vitin e kaluar dhe këtë shtator. Rrjedhimisht kapitulli i bashkëpunimit në çështjet e energjisë mes dy vendeve ka filluar ndërsa operatorët ilegal serb do të largohen për të lejuar normalizimin e situatës së energjisë në pjesën veriore të Kosovës. Bashkëpunimi ndërshtetëror në fushën e energjisë do të kontribuojë edhe në stabilitetin energjetik në rajon, në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, duke i dhënë fund kështu shkeljes së këtij traktati nga ana e Serbisë në raport me Kosovën.

Lidhur me Telekomin, është bërë një progres i mirë në përafrimin e qëndrimeve të palëve rreth planit për zbatim/veprim, megjithatë kjo çështje mbetet ende për t'u finalizuar.

Është bërë progres i mirë në mbledhjen e të hyrave doganore në pikëkalimet kufitare veriore, si dhe në krijimin e Fondit të Zhvillimit dhe bordin e tij menaxhues i cili tashmë ka mbi 3 milion euro. Me këto hapa, kemi pasur sukses jo vetëm në vendosjen e sundimit të ligjit në këtë fushë, që mungonte për një kohë të gjatë, por gjithashtu edhe në ofrimin e investimeve zhvillimore shtesë në veri, për të cilat mbetemi të angazhuar.

Qeveria e Kosovës konsideron se Bashkimi Evropian ka luajtur një rol qenësor në lehtësimin dhe përshpejtimin e këtij progresi. BE-ja ka arritur të tejkalojë çfarëdo

barriere të çdo natyre qoftë politike apo teknike, duke përfshirë mungesën e vullnetit të Serbisë për të bashkëpunuar, përmes një roli proaktiv në komunikimin e qartë të kushtëzimeve midis detyrimeve të palëve për dialogun e Brukselit dhe perspektivës së tyre evropiane. Përveç kësaj, zyrtarët e BE-së kanë realizuar bisedime të drejtpërdrejta të shumta dypalëshe me palën serbe, përmes vizitave në Beograd dhe/ose komunikimit me internet dhe VTC. Ngjashëm, kontributi i EEAS në Kosovë, Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe Qeverisë së SHBA-ve ka qenë tejet i rëndësishëm në arritjen e progresit në terren në të gjitha fushat, dhe veçanërisht në funksionimin ligjor të komunave veriore.

Ne, Qeveria e Kosovës dhe kryeministri Hashim Thaçi, kemi marrë pjesë në të gjitha nivelet e bisedimeve politike dhe teknike të mbajtura në Bruksel me lehtësimin e PL Ashton para zgjedhjeve nacionale (në qershor 2014), ndërsa pas shpalljes së rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, ne rifilluam pjesëmarrjen vetëm në bisedimet teknike për zbatimin e marrëveshjeve. Poashtu kemi përdorur mënyra të ndryshme për t'ia komunikuar Brukselit nevojën për përrshpejtimin e procesit të zbatimit, duke përfshirë disa vizita zyrtare në Bruksel për të informuar dhe për të diskutuar mënyrat për të shpejtuar procesin e zbatimit.

Sa i përket kohës, më së shumti rezultate konkrete janë arritur gjatë muajit shtator dhe shpresojmë se kështu do të vazhdojë.

Duke folur në përgjithësi, që nga 19 prilli 2013, kur është arritur Marrëveshja e Brukselit, përparime në zbatim janë shënuar në nivele të ndryshme për çështje të ndryshme të trajtuara nga kjo Marrëveshje, si dhe në marrëveshjet e dialogut teknik. Ky progres mund të shihet në marrëdhëniet e përmirësuara në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, normalizimin në rritje të situatës në pjesën veriore të Kosovës, përmes integritit të qytetarëve serbë të asaj pjese në institucionet e Kosovës, shpërbërjen e strukturave ilegale serbe që veprojnë në Kosovë që nga viti 1999 dhe avancimin e integritit evropian për të dyja shtetet.

Theksojmë me shqetësim tendencat për të shmangur ose vonuar zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, pasi që ato krijojnë hapësirë për zhvillime të ndryshme negative në komunat veriore dhe tregojnë se Serbia ende nuk ka hequr dorë nga synimet dhe ndërhyrjet në punët e brendshme të Kosovës.

Në këtë periudhë, ne vëmë re me shqetësim pengesat në vendosjen e sundimit të ligjit dhe normalitetit në katër komunat veriore të shkaktuara nga kryetarët ilegal të komunave, grupet paramilitare dhe kriminale, të cilat e kanë penguar progresin e

komunitetit serb në Kosovë gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Këto struktura vazhdojnë të rrezikojnë personelin e agjencive vendore dhe ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, siç u dëshmuua së fundmi në rastin e EULEX-it , përfshirë këtu edhe barrikatat që vazhdojnë të parandalojnë lirinë e lëvizjes.

Në këtë kuadër, nga mesi i qershorit, i përjetuam tensionet në Mitrovicë që buruan nga heqja e njëanshme e një barrikadë nga Ura e Ibrit dhe vendosja e të rejave, që kërcënuan me përkeqësimin e situatës së sigurisë në pjesën veriore. Ne patëm sukses në frenimin e këtyre tensioneve duke vepruar me maturi dhe në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, që rezultoi me marrëveshjen e lehtësuar nga BE-ja për të zgjidhur çështjen e barrikadave dhe për të siguruar se kjo urë përfundimisht do të bëhet një urë e lirisë së plotë të lëvizjes në përputhje me standardet e BE-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës i çmon lartë përparimet e bëra në Dialogun e Brukselit, dhe ne mbesim plotësisht të përkushtuar për të çuar përpara të gjitha aspektet e këtij dialogu. Megjithatë, shumë mbetet për tu bërë në lidhje me disa çështje të rëndësishme që mbeten ende në pritje të zgjidhjes, të cilat do të siguronin një bazë të qëndrueshme për arritjen e qëllimeve të përmendura më lart të dialogut të Brukselit.

Ky Raport është vazhdim i raportit paraprak të përgatitur nga Qeveria e Kosovës më 16 janar 2014 dhe pasqyron gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve për periudhën raportuese. Për më shumë informacion në fushat ku nuk ka pasur përparime, lexuesi këshillohet t'i referohet raportit paraprak i cili mund të gjendet në linkun:

<http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,252>.

1. FUNKSIONIMI I KATËR KOMUNAVE VERIORE TË KOSOVËS

Pas përfundimit të suksesshëm të zgjedhjeve lokale të cilat u organizuan në tërë Kosovën në nëntor të vitit 2013, autoritetet e zgjedhura lokale të katër komunave të pjesës veriore të Kosovës: Komuna e Mitrovicës veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi, hynë në një proces ligjor dhe demokratik të qeverisjes lokale. Inaugurimi zyrtar i organeve komunale në të katër komunat (11 janar 2014) dhe miratimi i statuteve komunale (16 maj 2014) në përputhje me ligjet e Kosovës, siç është kërkuar në Marrëveshjen e Brukselit, shënoi një progres të rëndësishëm në zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Kjo hapi rrugën drejt normalizimit dhe demokratizimit të kësaj pjese të vendit tonë që mungonte për vite.

Inaugurimi i suksesshëm i organeve komunale në katër komunat veriore ishte një proces sfidues dhe i ndjeshëm që kërkonte bashkëpunim intensiv të të gjithë aktorëve, Qeverisë së Republikës të Kosovës, Bashkimit Evropian, PSBE, Ambasadës Amerikane dhe kryetarëve të zgjedhur, duke pasur parasysh tranzicionin e rëndësishëm që përfshinte ky proces. Të gjithë kryetarët e zgjedhur të komunave dhe delegatët e kuvendit i kryen me sukses betimet e tyre, përveç kryetarit të zgjedhur të komunës veriore të Mitrovicës që dështoi ta bëjë këtë, prandaj u zëvendësua nga një tjetër kryetar i cili u zgjodh në raundin e ri të zgjedhjeve në shkurt të vitit 2014.

Procesi i miratimit të statuteve komunale ka qenë i vështirë por përfundoi me sukses. Për këtë u deshën dy faza. Faza e parë ishte kur komunat miratuan statutet të cilat në disa pjesë nuk ishin në përputhje me Ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit (12 mars 2014). Faza e dytë përfshinë harmonizimin ligjor të statuteve të miratuara përmes një procesi të gjatë të negociatave në mes të Qeverisë së Kosovës dhe kryetarëve të këtyre komunave, që në pjesën më të madhe u lehtësua nga PSBE-ja dhe Ambasada Amerikane. Statutet e harmonizuara sipas ligjit janë miratuar nga kuvendet komunale më 16 maj 2014, ndërsa miratimi i simboleve dhe flamujve mbeti për një fazë të mëvonshme dhe do të ndjekë një procedurë të një vendimi të veçantë në përputhje me ligjin përkatës të Kosovës.

Funksionimi legal i katër komunave veriore ka sjellë qeverinë legjitime lokale më afër qytetarëve të këtyre komunave duke i dhënë fund strukturave ilegale që ishin funksionale para Marrëveshjes së Brukselit.

Ekziston një bashkëpunim në rritje në mes të autoriteteve lokale dhe autoriteteve qendrore duke shtyrë përpara agjendën për një cilësi më të mirë të jetës së qytetarëve në këtë pjesë të Kosovës. Jemi të lumtur të nënvizojmë se integrimi i qytetarëve serbë të kësaj

pjese në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës është në një rrugë të mirë, ndërkohë që Qeveria e Kosovës vazhdon konsolidimin e sovranitetit, demokracisë, sundimit të ligjit dhe perspektivës ekonomike në tërë Kosovën për të mirën e të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu. Vlen të theksohet që një kontribut i çmuar në këtë proces është duke dhënë PSBE-ja dhe Ambasada e SHBA-ve në Kosovë.

Progresi në funksionimin e katër komunave të pjesës veriore mund të shihet në funksionimin e organeve komunale, sidomos në zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të komunave dhe kryesuesve të kuvendeve komunale. Për më tepër, është bërë progres në lidhje me njoftimin dhe dërgimin e akteve komunale për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Para nesh janë sfidat nga fusha të ndryshme, siç janë: vështirësitë me përpunimin e listës së pagave të personelit komunal, planifikimin e buxheteve komunale për vitin 2015; themelimin e administratave lokale dhe departamenteve komunale; dhe tranzicionin e stafit ekzistues të administratës komunale duke ndjekur parimin e gjithë përfshirjes. Qeveria e Kosovës dhe partnerët po punojnë ngushtë për të tejkaluar këto vështirësi. Për këtë qëllim, në fillim të shtatorit është themeluar Grupi Punues për funksionimin e katër komunave i kryesuar nga Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, i përbërë nga përfaqësuesit e Qeverisë, kryetarët e komunave përkatëse dhe partnerët ndërkombëtarë. Grupi punues është duke i bërë të gjitha përpjekjet për të trajtuar sfidat në buxhetet komunale, strukturat organizative të administratave komunale dhe tranzicionin e stafit ekzistues në një administratë të re komunale, duke u siguruar se është zbatuar ligji i Kosovës për nëpunësit civilë dhe është siguruar paanshmëria politike. Për më tepër, Qeveria ka përgatitur udhëzimet për numrin dhe sistemimin e stafit komunal dhe në bazë të një programi të veçantë trajnimit, janë aranzhuar të gjitha aktivitetet për të trajnuar zyrtarët financiarë komunal. Është bërë progres në lidhje me emërimin dhe certifikimin e zyrtarëve financiar dhe komunat kanë filluar të përdorin buxhetet e tyre dhe të realizojnë shpenzimet e buxheteve komunale.

Me një shqetësim të veçantë, konstatojmë pengesat për funksionimin e autoriteteve legale komunale në katër komunat veriore të cilat pengohen nga funksionimi i vazhdueshëm i kryetarëve ilegal të komunave të cilët vazhdojnë të marrin mbështetje nga Serbia. Qeveria e Kosovës i ka ngritur këto shqetësime në takimet me zyrtarët e BE-së në Bruksel duke kërkuar nga Serbia që të përmbush plotësisht kushtet e Marrëveshjes së Brukselit përmes shuarjes së funksionimit të kryetarëve ilegalë.

2. SIGURIA

Është bërë progres i mirë në lidhje me çështjet e sigurisë. Shpërbërja e strukturave ilegale policore serbe (ish strukturat paralele të Ministrisë Serbe të punëve të brendshme) në pjesën veriore të Kosovës dhe integrimi i plotë i personelit serb në policinë e Kosovës, duke përfshirë edhe procesin e gradimit të tyre bazuar në ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit, garanton një cilësi më të lartë të sigurisë për të gjithë në Kosovë. Duke u bazuar në Marrëveshjen e Brukselit, Policia e Kosovës ka graduar 23 ish-zyrtar të MUP-it në gradat si në vijim: 6 zyrtar të policisë janë promovuar në gradën e majorit policor; ndërsa 17 zyrtar policor janë promovuar në gradën e togerit policor. Me përfundimin e procesit të gradimit, Kosova ka zbatuar të gjitha zotimet në lidhje me Marrëveshjen Brukselit dhe Planin e zbatimit.

Më shumë mbetet të bëhet në fushën e sigurisë në katër komunitet e pjesës veriore, duke përfshirë shpërbërjen e strukturave të mbetura paralele të tilla si struktura paramilitare e ashtuquajtur Mbrojtja Civile (SMC). Qeveria e Kosovës ka prezantuar një plan gjithëpërfshirës për integrimin e anëtarëve të kësaj strukture në institucionet civile Kosovës dhe i ka kërkuar BE-së që të përshpejtojë këtë proces. Megjithatë Serbia është duke u vonuar në paraqitjen e planit të shpërbërjes dhe marrjen e vendimeve për ndryshimet përkatëse ligjore dhe organizmin strukturorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë, me të cilin zyrtarisht do t'i jepet fund funksionimit të "SMC-së" (për më shumë detaje mbi këtë çështje, ju lutem referojuni raportit¹ të mëhershëm, duke marr parasysh se situata ka mbetur e pandryshuar). Gjithashtu, BE pritet të dal me një Udhëzues për shpërbërjen e të ashtuquajturës SMC, në periudhën vijuese.

¹ "GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT", Raporti i dorëzuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës tek Bashkimi Evropian/Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm, më 16 janar 2014, faqe 8-10, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,252>

3. DREJTËSIA

Në çështjet e drejtësisë, është arritur progres më shumë në planifikimin e zbatimit të marrëveshjes se sa në zbatimin praktikë. Plani i zbatimit në drejtësi është dakorduar në pjesën më të madhe por ende nuk është finalizuar. Ky Plan parasheh zbatimin e legjislacionit të Kosovës dhe funksionimin e sistemit unitar të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës, përmes themelimit të një Gjykate themelore dhe një Zyre të prokurorisë për rajonin e Mitrovicës. Megjithatë, disa detaje më shumë të natyrës kuantitative kanë mbetur ende të hapura për shkak të vonesave të shkaktuara nga zgjedhjet parlamentare të mbajtura në të dy shtetet. Ne mirëpresim përfundimin e planit të zbatimit i cili do të hapë rrugën për konsolidimin e sistemit unitar të drejtësisë në pjesën e veriore të vendit dhe integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve Serbë të Kosovës në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Ndërkohë, që nga shtatori i vitit të kaluar, gjykatat dhe zyrat paralele të prokurorisë janë shpërbërë në përputhje me planin e dakorduar dhe rastet i janë transferuar EULEX-it në pritje të funksionimit të atyre legale². Në terren nuk ka indikacione të qarta apo të dukshme se strukturat paralele në drejtësi janë mbyllur në tërësi. Ekzistojnë disa indikacione se strukturat paralele gjyqësore në veri të Kosovës janë ende duke pranuar raste të reja për çështje urgjente në rastet civile. Serbia vazhdon të paguaj pagat për personelin gjyqësorë paralel që vepron në Kosovë.

4. LIGJI I AMNISTISË

Kosova ka miratuar Ligjin për Amnistinë më 17 shtator të vitit 2013 dhe ky ligj është duke u zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e integritit të qytetarëve serbë të pjesës veriore në institucionet e Kosovës ashtu siç parashikohet nga Marrëveshja e Brukselit. Konkretisht, Ligji i amnistisë është zbatuar në procesin e integritit të policëve serbë në Policinë e Kosovës. Po ashtu ky ligj do të zbatohet në procesin e planifikimit për integrimin e anëtarëve të "SMC-së" në institucionet civile të Kosovës pas shuarjes që pritet të ndodhë, dhe do të vlejë për të gjitha fushat e tjera siç parashikohet nga Marrëveshja e Brukselit. Miratimi i këtij ligji e konfirmon vullnetin politik të Qeverisë së Kosovës për integrimin e qytetarëve serbë të veriut në institucionet e Kosovës. Ne e konsiderojmë Ligjin për Amnistinë si një prej masave të rëndësishme për ndërtimin e mirëbesimit në përpjekjet e institucioneve të Kosovës për integrimin e plotë të minoritetit

² Për më shumë detaje mbi këtë çështje, shih po aty, faqe 12-13

serb, që i shërben qëllimit të rivendosjes së besimit të dëmtuar nga ndërhyrjet negative të Serbisë që nga përfundimi i luftës në vitin 1999.

5. MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE

Progres i mirë është arritur në mbledhjen e të hyrave nga doganat në vendkalimet kufitare veriore në mes të Serbisë dhe Kosovës, si dhe në krijimin e Fondit Zhvillimor dhe bordin e tij menaxhues. Sipas raportit të Doganës së Kosovës, që nga 14 dhjetori 2013, kur filloi zbatimi i kësaj marrëveshjeje, procesi i përgjithshëm i mbledhjes së të hyrave në pikëkalimet kufitare Jarinjë dhe Bërnjak shkoi mirë, pa probleme të mëdha dhe rezultoi me mbledhjen e mbi 3 milion eurove.

Në ndërkohë, është shënuar progres në procesin e licencimit të mallrave të kontrolluara që i mundëson kompanive private të kryejnë aktivitetet e tyre, duke përfshirë mekanizmat e licencimit të përkohshëm në mënyrë që të shmanget ndonjë boshllëk në aktivitetet e tyre. Autoritetet e Kosovës kanë lëshuar 53 licenca/certifikata të ndryshme dhe 169 certifikata/licenca të përkohshme (formular të përkohshëm për licencim të eksportit/importit) për kompanitë nga pjesa veriore të cilat kanë aplikuar për licencim. Që nga fillimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, numri i kompanive private nga veriu të cilat janë regjistruar nën sistemin e Kosovës është rritur (mbi 400 deri më sot).

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje jo vetëm që ka ndihmuar në vendosjen e sundimit të ligjit në këtë fushë dhe zvogëlimin e ekonomisë jo-formale, por gjithashtu ofron një burim shtesë për investimet zhvillimore në pjesën veriore për të cilën Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar.

6. FONDI PËR ZHVILLIM

Fondi për zhvillim është themeluar në dhjetor të vitit 2014 për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik të pjesës veriore të Kosovës për të mirën e popullatës lokale. Të hyrat e mbledhura në pikëkalimet kufitare Jarinjë dhe Bërnjak (taksat e zbatueshme doganore dhe akciza duke përfshirë TVSH-në) nga kompanitë që operojnë dhe mallrat e destinuara për popullsinë lokale të komunave të pjesës veriore janë duke u transferuar në Fondin Zhvillimorë në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit dhe legjislacionin e Kosovës. Paratë në Fondin Zhvillimorë janë publike dhe do të trajtohen si të tilla gjatë menaxhimit dhe shpenzimit të tyre. Fondi Zhvillimorë ka mbi 3 milionë euro të mbledhura nga të

hyrat në dy pikat kufitare në pjesën veriore që nga dhjetori i vitit të kaluar e deri më tani. Fondi do të rritet vazhdimisht sipas rrjedhës së mbledhjes së të hyrave dhe nga kontributet e tjera të mundshme të cilat mund të vijnë nga donatorë të ndryshëm të huaj, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Bordi i Fondit Zhvillimorë, i përbërë nga PSBE-ja, Ministri i Financave të Kosovës dhe një përfaqësues i komunitetit serb nga katër komunat veriore, kanë punuar në mënyrë që ta bëjnë Fondin funksional. Termat e përkohshme të Referencës për funksionimin e Fondit Zhvillimorë u miratuan nga Bordi në dhjetor të vitit 2014. Në këtë fazë, Bordi është duke punuar mbi kriteret dhe procedurat për financimin e projekteve, takimi i Bordit është planifikuar të mbahet në dy javët e ardhshme për të miratuar kriteret dhe për të hapur thirrjen për propozime për projekte.

7. ZYRAT NDËRLIDHËSE

Sa i përket marrëveshjes për zyrat ndërlidhëse, është bërë progres i mirë pas regjistrimit të Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë, që është përmbyll më 4 prill të vitit 2014 me një vonese të konsiderueshme dhe vetëm pas kërkesave të vazhdueshme nga pala Kosovare. (Kosova dhe Serbia shkëmbyen Zyrat Ndërlidhëse më 17 qershor 2013).

Me kërkesë të Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë dhe Zyrtarit Ndërlidhës (ZN), Qeveria e Kosovës e ka kryer menjëherë regjistrimin dhe ka lëshuar dokumentet zyrtare të identifikimit për zyrtarin ndërlidhës, anëtarët e familjes së tij dhe stafin e tij. Si rrjedhojë, Zyra e Administratës Tatimore të Kosovës ka lëshuar certifikatën e numrit fiskal për ta.

Zbatimi i Marrëveshjes për Zyrat Ndërlidhëse ende ka çështje në pritje siç është ajo e vulave zyrtare të zyrave përkatëse të ndërlidhjes. Të dy Zyrat Ndërlidhëse ende janë duke operuar pa vula. Në takimin e fundit, të mbajtur në Bruksel më 7 mars të vitit 2014 pozicioni i palëve ka qenë si më poshtë: pozicioni i Kosovës ishte se vula duhet të jetë e njëjtë me atë të misioneve diplomatike të Kosovës në gjithë botën, me stemën e Republikës së Kosovës dhe mbishkrimin i cili thotë: Zyra Ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi. Pala serbe ka prezantuar pozicionin e saj, sipas të cilit vulat duhet të jenë pa simbole dhe të ketë mbishkrimin i cili thotë: Zyra ndërlidhëse në Prishtinë (për zyrën ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë) dhe Zyra ndërlidhëse në Beograd (për zyrën ndërlidhëse të Kosovës në Serbi). Dallimi i palëve në lidhje me vulat mbetet i pazgjidhur.

Për më tepër, ende nuk është arritur marrëveshje në lidhje me ballinën letrave dhe dokumenteve zyrtare. Në takimin e fundit trepalësh, palët arritën mirëkuptimin që

formulimet dhe pamjet e kreut e letrës të jenë të njëjta sikurse ato që do të përcaktohen për vulat.

Pala kosovare ngriti çështjen për personel shtesë në të dy zyrat përkatëse. Pala serbe nuk ishte e gatshme të flasë për këtë çështje. Lehtësuesi i BE-së sugjeroi që kjo çështje të adresohet në fazat e ardhshme.

Sa i përket trajtimit të kërkesave për vizita zyrtare (në Kosovë dhe në Serbi), u dakordua që të dy ZN-të duhet të marrin përsipër trajtimin e vizitave zyrtare. U dakordua që nëse nuk ka kundërshtime nga cilado palë deri më 28 mars të vitit 2014, ZN-të do të marrin përsipër përgjegjësinë për trajtimin e vizitave të tilla që nga 31 marsi i vitit 2014. Më 4 prill të vitit 2014, është mbajtur një video-konferencë/VTC trepalëshe për të diskutuar modalitetet për zbatimin e trajtimit të kërkesës për vizita zyrtare nga ZN-të përkatës. Mirëpo, përkundër zgjidhjeve të dakorduara, pala serbe u tërhoq duke pohuar se nuk i kanë kompetencat për të vendosur deri në formimin e qeverisë së re në Serbi.

8. ASOCIACIONI

Themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe pritet të bëhet pasi që plani i zbatimit të jetë dakorduar në Bruksel. Asociacioni do të ndjek modelin e asociacionit ekzistues të komunave në Kosovë, duke u bazuar në ligjet e Kosovës dhe marrëveshjen e Brukselit. Në këtë linjë, në dhjetor të vitit 2013, autoritetet e Kosovës i paraqiten BE-së një draft statut të Asociacionit, të hartuar në bazë të Ligjeve të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit. Ekipi menaxhues, një ekip transitor katër anëtarësh është duke funksionuar në sigurimin e mbështetjes logjistike/teknike dhe shërbimeve të tjera në bazë të Termave të Referencës të dakorduara në Bruksel. Anëtarët e këtij ekipi, të cilit në fillim refuzuan të bashkëpunojnë me autoritetet e Kosovës/MAPL-në, tani janë duke ndryshuar pozitivisht drejt bashkëpunimit më të mirë dhe së fundmi kanë nënshkruar kontratat me MAPL-në për marrjen e pagave të tyre nga buxheti i Kosovës. MAPL-ja mbetet e përkushtuar që të mbështes punën e ekipit menaxhues i cili do të jetë funksional deri në themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Qeveria e Kosovës pohon se themelimi i këtij Asociacioni do të bëhet pas përfundimit të procesit të zbatimit të marrëveshjeve në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, që çon në krijimin e kushteve normale të funksionimit të tij.

9. MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT (IBM)

Pas një viti negociatash, më 4 shtator të vitit 2014 në Bruksel, u arrit dhe u nënshkrua marrëveshja për ndërtesat e përhershme të IBM-it nga tri palët, Kosova, Serbia dhe BE-ja. Kjo marrëveshje shënon një progres të rëndësishëm drejt zbatimit të plotë të Marrëveshjes së IBM dhe Protokollit Teknik. Marrëveshja parashikon ndërtimin e pikëkalimeve kufitare të përhershme të IBM në gjashtëpikëkalimet kufitare duke iu përmbajtur dizajnit dhe lokacionit të dakorduar dhe në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira evropiane. Komisioni Evropian/Drejtoria për zgjerim ka ndarë fondin prej rreth 21 milion euro dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha procedurat për planifikim dhe ndërtim. Fondi është i përbërë nga fondet IPA të të dyja shteteve, dhe i njëjti tashmë është identifikuar dhe do të ndahet zyrtarisht në tetor 2014.

Ngjashëm, pas pothuajse një viti bisedimesh, u arrit marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave veterinarë për ushqim të kafshëve, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2014, krahas Çertifikatave fitosanitare që u dakorduan në një fazë të mëhershme të bisedimeve. Si hap i ardhshëm, të dyja palët do ta zgjerojnë modelin dhe gjuhën e miratuar të certifikatave veterinarë për eksportin e kafshëve.

Siç është rënë dakord gjatë takimit të GI të IBM në shtator 2013, bashkëpunimi mes autoriteteve të IBM të të dy vendeve është në nivel të kënaqshëm, në linjë me Marrëveshjen e Brukselit dhe standardet evropiane, e cila mund të shihet edhe përmes takimeve të rregullta të nivelit lokal dhe rajonal. Takimi i dytë i nivelit qendror u mbajt në Beograd më 11 shtator 2014.

10. LIRIA E LËVIZJES

Sa i përket çështjes së lirisë së lëvizjes, edhe pse funksionimi i tij ka qenë i kënaqshëm në këtë periudhë raportuese, disa çështje mbeten për t'u trajtuar në një mënyrë më të përshpejtuar. Çështja e Sigurimit të automjeteve në kufi ka mbetur ashtu siç është dakorduar në fillim të hyrjes në fuqi të konkluzioneve për Lirinë e Lëvizjes e cila ka qenë një pengesë e vazhdueshme për një lëvizje të lirë dhe të pangarkuar të qytetarëve nga të dy vendet. Është bërë shumë në këtë drejtim, megjithatë memorandumimi i mirëkuptimit (MM) që është hartuar së bashku ka mbetur i papërfunduar, dhe marrëveshja nuk është arritur ende. Hapja e pikë kalimeve kufitare (PKK) të reja transite për në vendet e treta për qytetarët e Kosovës siç është kërkuar nga pala kosovare dhe heqja e dokumentit Hyrës/Dalës në pikë kalimet e caktuara kufitare për qytetarët e Kosovës ka qenë e

paraparë të shqyrtohej në mbledhjen e 25 gushtit të vitit 2014, por përkundër gatishmërisë së delegacionit të Kosovës për të marrë pjesë në takimin në Bruksel, delegacioni serb me arsyetimin e pushimeve verore nuk kanë marrë pjesë. Më 16 shtator, në takimin e Brukselit mbi mbledhjen e të hyrave doganore, delegacioni serb i është përgjigjur pozitivisht kërkesës sonë për hapjen e pikë-kalimeve të reja kufitare transite në Serbi për të lehtësuar më tej lirinë e lëvizjes për qytetarët e Kosovës. Kjo marrëveshje siguron qarkullimin e lirë transit për qytetarët e Kosovës në aeroportet e Beogradit dhe të Nishit, si dhe kalimin transit përmes Serbisë në vendet e treta, duke përfshirë edhe pikë kalimet kufitare të dyta për në Kroaci dhe Hungari dhe hapjen e pikë kalimeve kufitare për në Bullgari, Rumani dhe Maqedoni. Kjo marrëveshje duhet të fillojë të zbatohet brenda dy muajve ndërsa nga 22 shtatori 2014 qytetarët e Kosovës mund të përdorin aeroportin e Beogradit për transit. Marrëveshja për heqjen e dokumentit Hyrës/Dalës në pikë kalimet e caktuara kufitare për qytetarët e Kosovës nuk është arritur ende.

Vlerësojmë se zbatimi i marrëveshjes në fushën e lëvizjes së lirë në përgjithësi është duke ecur mirë. Megjithatë, çështja e heqjes së barrikadave ende nuk ka përfunduar, ndonëse shumica e tyre janë larguar tashmë, përderisa kohë pas kohe ato edhe gjenerojnë tensione.

10.1 Tensionet me barrikadat mbi urën e lumit Ibër në Mitrovicë

Rasti më famëkeq është ai i barrikadës mbi urën e lumit Ibër në Mitrovicë e cila në vend që të hiqet, u ri-shfaq si burim i tensioneve gjatë muajit qershor, menjëherë pas zgjedhjeve nacionale në Kosovë. Në veprimet e njëanshme nga ana e Serbisë dhe kryetarit të komunës së Mitrovicës së Veriut, barrikada u hoq nga Ura e Ibrit dhe u zëvendësua me një lloj të ri të barrikadës "park", e cila jo vetëm që vazhdoi të pengoj lirinë e lëvizjes, por ajo gjithashtu është duke provokuar ngritjen e tensioneve dhe pasigurinë me potencial për destabilizimin e situatës në Mitrovicë.

Qeveria e Kosovës iu qas kësaj shtate me kujdes dhe në koordinim të plotë me PSBE-në, Ambasadën Amerikane dhe KOMKFOR-in, duke i bërë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur këtë çështje nëpërmjet dialogut të Brukselit dhe duke u përpjekur t'i zbusë reagimet/protestat e popullatës në Mitrovicën jugore. U nevojitën gati një muaj bisedime dhe tensione, si dhe veprime të tjera për barrikadat e reja përreth urës dhe kundër-reagimi i popullsisë në komunën veriore të Mitrovicës nëpërmjet ndërtimit të disa pengesave të reja, derisa plani për heqjen e barrikadave dhe pengesave tjera u arrit në Bruksel më 22 korrik 2014.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, së bashku me delegacionin e Republikës së Kosovës, me ftesë të PL të BE, baroneshës Ashton, ka marrë pjesë në dy takime në Bruksel për çështjen e heqjes së barrikadave (më 11 dhe 22 korrik 2014).

Zëvendëskryeministrja Tahiri, në këto takime prezantoi qëndrimin e Qeverisë së Kosovës se vendosja e barrikadave është e papranueshme dhe në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit; prandaj ato duhet të hiqen për të respektuar lirinë e lëvizjes, sipas standardeve evropiane. Ajo po ashtu konfirmoi se Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për të bashkërenduar veprimet me Bashkimin Evropian në lidhje me heqjen e barrikadave mbi urë, si dhe pengesave tjera rreth saj.

Më 22 korrik 2014, në takimin trepalësh, pas disa orë diskutimesh dhe me propozimin e BE-së, u dakorduar për heqjen e barrikadave dhe revitalizimin e urës në një proces gradual dhe paralel, një proces në të cilin BE-ja do të angazhohet drejtpërdrejt, duke përfshirë edhe ndihmën financiare për projekte që kanë për qëllim përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Mitrovicës.

Plani i BE-së përfshinë elementet vijuese:

1. Respektimin e ligjeve të Kosovës,
2. Bërjen e një vlerësim teknik të stabilitetit statik të strukturës së urës së Ibrit nga ana e BE-së
3. Hartimin e projektit për revitalizimin e urës, si dhe zbatimin e revitalizimit / restaurimit të urës së Ibrit nga ana e BE-së.

Në shtator të vitit 2014, ekspertët e angazhuar nga BE-ja, do të prezantojnë rezultatet e vlerësimit për të vazhduar më pas me revitalizimin dhe funksionalizimin e plotë të urës, në funksion të lëvizjes së lirë.

Palët ranë dakord gjithashtu që të vazhdojë moratoriumi i cili ndalon çdo veprim të vendosjes së barrikadave në atë pjesë dhe në rast të dështimit për përmbushjen e këtij moratoriumi, institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës do të përgjigjen me forcën e ligjit dhe në funksion të zbatimit të ligjit.

Kryetarët e komunave të Mitrovicës së Jugut dhe Veriut, Agim Bahtiri dhe Goran Rakiq, të cilët gjithashtu ishin prezent në takim, shprehën përkushtimin e tyre që të angazhohen dhe bashkëpunojnë në normalizimin e situatës si dhe në zbatimin e planit të BE-së, duke u pajtuar se ky plan është në interes të të gjithë qytetarëve të Mitrovicës.

11. TREGTIA E LIRË

Lidhur me çështjen e tregtisë së lirë mes dy vendeve (Marrëveshja për vula doganore), zbatimi është duke shkuar mjaft mirë. Herë pas here, janë identifikuar shkelje të marrëveshjes nga ana e Serbisë në përdorimin e vulave ilegale dhe provokative të ish-strukturave paralele në fushën e doganave dhe akronimeve të tjera provokuese në dokumente. Pala e Kosovës ka ngritur shqetësime lidhur me këto çështje me zyrtarët e BE-së dhe palës serbe në disa takime të mbajtura gjatë këtij viti në çështje të IBM-it apo doganave; mbetet të shihet nëse ato do të zgjidhen.

12. BASHKËPUNIMI RAJONAL

Progres i konsiderueshëm është bërë me anëtarësimin e Kosovës në organizatat të rënëdëshme rajonale. Kosova ka fituar statusin e anëtarit të plotë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC) vitin e kaluar dhe në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug Lindore (SEECF) më 26 qershor 2014. Kosova gjithashtu është pranuar në Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) në nëntorin e kaluar dhe iu bashkua Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës këtë qershor. Së voni, është konfirmuar anëtarësimi i Kosovës në organizatat rajonale që merren me migracionin, menaxhimin e kufijve dhe zbatimin e ligjit - MARRI.

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi e ndjek rrugën e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Kosovës në organizata dhe iniciativa të tjera relevante rajonale, edhe pse nuk janë hequr të gjitha pengesat nga ana e Serbisë, përkundër Marrëveshjes së Brukselit në këtë çështje të arritur që nga shkurti i vitit 2012, dhe përkundër faktit se të dy palët e pranojnë se bashkëpunimi rajonal është i dobishëm për të gjitha vendet dhe mbështet perspektivën e tyre evropiane. Disa nga shembujt ku pengesat e tilla janë evidentuar përfshijnë anëtarësimin në Qendrën për Bashkëpunim në Siguri (RACVIAC), Qendra e Evropës Juglindore për zbatim të ligjit (SELEC), Drejtorinë Evropiane për Cilësinë e Mjekësisë dhe Kujdesit Shëndetësor, Iniciativën e Bashkëpunimit Evropian, Konventën e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore, etj.

13. ENERGJIA

Në çështjet e energjisë ka pasur një progres të madh. Plani i zbatimit mbi Energjinë është nënshkruar nga të gjitha palët, Kosova, Serbia dhe BE-ja, më 15 shtator 2014. Po ashtu është nënshkruar marrëveshja Inter-TSO nga operatorët e Transmisionit të Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht KOSTT dhe EMS dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë më 12 shtator 2014.

Duhet përmendur se negociatat në të dyja çështjet kanë zgjatur më shumë se një vit qëkur është arritur Marrëveshja mbi Energjinë më 8 shtator 2013, dhe ato kryesisht janë mbajtur në takime bilaterale dhe komunikime përmes internetit për shkak të dinamikës së zgjedhjeve në të dyja vendet. Në pjesën e parë të vitit, është arritur Marrëveshja kornizë e bashkëpunimit në mes të operatorëve të transmisionit të Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht KOSTT dhe EMS, e cila është nënshkruar dhe garantuar edhe nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në fakt, negociatat mbi çështjet e energjisë kanë zgjatur rreth katër vjet, duke filluar në prill të vitit 2011 në kuadër të Dialogut teknik dhe duke u përfunduar në Dialogun e normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve të lehtësuara nga BE-ja dhe mbështetur nga SHBA-të.

I gjithë ky progres u bë i mundur me rolin ndërmjetësues të Komisionit të BE-së/DP-së për zgjerim dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të cilët kanë qenë të rëndësishëm në lehtësimin dhe përshpejtimin e procesit.

Me përfundimin e miratimit formal të të dy dokumenteve, Qeveria e Kosovës është e sigurt se jemi duke hapur një kapitull të ri të bashkëpunimit për energjinë në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, të bazuar në vlerat dhe standardet evropiane. Vendosja e marrëdhënieve në lidhje me sektorin energjinë në mes të dy shteteve me lehtësimin dhe garancitë e BE-së padyshim do të kontribuojë për shërbime më të mira të energjisë për qytetarët dhe rritjen e stabilitetit energjetik në rajon, ndërsa i jep fund operatorëve ilegal në pjesën veriore të Kosovës dhe shkeljes së Traktatit të Athinës nga ana e Serbisë në raport me Kosovën.

14. TELEKOMUNIKACIONI

Sa i përket çështjes së telekomunikacionit, ka progres të mirë në përfundimin e Plani të veprimit, me disa çështje që ende presin zgjidhje. Ngjashëm si në rastin e çështjeve të energjisë, negociatat për planin e zbatimit/veprimit për telekomunikacionin janë duke u zhvilluar për më shumë se një vit qëkur u arrit Marrëveshja (8 shtator 2013) dhe ato janë mbajtur kryesisht në takimet bilaterale dhe komunikimet në internet për shkak të dinamikës së zgjedhjeve në të dy vendet. Ne shpresojmë se Plani i zbatimit do të miratohet së shpejti. Miratimi nga ana jonë do të pasojë pas mbylljes së disa çështjeve të hapura në lidhje me ndarjen e kodit telefonik për Kosovën nga ana e ITU-së në të cilën BE-ja është e angazhuar në mënyrë intensive në bashkëpunim me Austrinë, e cili ka ofruar gatishmërinë që të aplikoj për një kod në emër të Kosovës.

15. REGJISTRI CIVIL

Marrëveshja për Regjistrin Civil është zbatuar plotësisht. Falë kësaj Marrëveshje, Serbia i ka kthyer Kosovës 12,036 libra të regjistrit civil (kopje të skanuara të librave dhe të certifikuara nga EULEX-i) që janë marrë nga Serbia gjatë kohës së luftës. Procesi i skanimit dhe verifikimit është kryer nga grupi trepalësh i ekspertëve me lehtësimin e EULEX-it i cili po ashtu ka bërë certifikimin e vërtetësisë së kopjeve të librave. U deshën gati dy vjet që të përfundohet zbatimi (nga 6 dhjetori 2011 deri me 6 mars 2014), edhe pse periudha e dakorduar ishte 9 muaj. Edhe pse ritmi i zbatimit nuk ishte i kënaqshëm, me rëndësi është zbatimi i suksesshëm i marrëveshjes. Sipas marrëveshjes, procesi i skanimit dhe verifikimit të librave është bërë nga ekipet trepalëshe në Nish (Serbi), ndërsa certifikimi është bërë nga EULEX-i dhe pastaj gradualisht i janë dorëzuar autoriteteve të Kosovës. BE-ja ka financuar këtë projekt dhe asistencë teknike është ofruar nga DRC-ja si partner zbatues i kontraktuar nga BE /PSBE.

Gjithsej 12, 391 libra të regjistrit civil i kanë takuar këtyre komunave: Lipjan (848), Obiliq (264), Fushë Kosovë (219), Drenas/Gllogoc/(430) Prishtinë (1013), Podujevë (1066), Gjilan (935), Kamenicë (824), Viti (726), Novobërdë (67), Ferizaj (741), Shtërpçë (243), Kaçanik (167), Shtime (270), Pejë (687), Istog (642), Mitrovicë (735), Zveçan (249), Zubin Potok (409) , Leposaviq (383), Vushtrri (919) dhe Skenderaj (554).

Vërejmë se gjatë procesit të verifikimit, grupi i eksperteve të Kosovës ka identifikuar edhe 320 libra të dyfishta në Serbi, që ne kërkojmë të kthehen në Kosovë në frymën e marrëveshjes, megjithatë ende nuk ka pasur përgjigje nga pala serbe.

16. KADASTRI

Sa i përket zbatimit të marrëveshjes për kthimin e dokumenteve kadastrale nga Serbia në Kosovë deri më tani nuk ka pasur progres. Pala e Kosovës ende nuk e ka miratuar ligjin për agjencinë e re teknike (Agjencia kosovare e krahasimit dhe verifikimit të pronave), edhe pse ky projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës. Ngurrimi i disa parlamentarëve për miratimin të këtij ligji dhe vonesat në inaugurimin e organeve të reja parlamentare pas zgjedhjeve nacionale të qershorit në Kosovë, e kanë mbajtur peng këtë ligj. Nga ana tjetër, pala serbe nuk ka bërë asnjë përparim në skanimin e dokumenteve kadastrale për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë që vendosi se Marrëveshja për kadastrin nuk është në përputhje me Kushtetutën e saj. Sipas njoftimeve të fundit nga BE-ja thuhet se pala serbe e ka kapërcyer këtë pengesë duke miratuar një dekret qeveritar në favor të zbatimit të tij (21 gusht 2014). Edhe pse, qeveria serbe ka lëshuar një dekret dhe Zyra e BE-së në Beograd ka vendosur të financojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje/procesin e skanimit, nuk dihet ende se deri ku ka arritur procesi i skanimit të dokumenteve kadastrale.

17. DIPLOMAT

Sa i përket çështjes së njohjes reciproke të diplomave universitare nuk ka pasur progres pozitiv, me përjashtim të procesit ndërkombëtar të certifikimit të kryer nga Asociacioni Evropian i Universiteteve (AEU). Siç është raportuar, deri më sot, ka pasur vetëm një rast ku një njohje zyrtare është lëshuar nga autoritetet në Serbi për një diplomë univeristare nga Kosova të certifikuar paraprakisht nga AUE. Përveç kësaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë kundër marrëveshjes së Brukselit për njohjen diplomave e komplikon edhe më tej procesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Për më tepër, marrëveshja fillestare për të angazhuar SPARK-un për lehtësimin e procesit të certifikimit të diplomave vlente për një periudhë dy vjeçare, deri në mars të vitit 2014. Kjo kohë tashmë ka kaluar, për këtë arsye një takim trepalësh për hapat e mëtejme është vendimtar.

17. SIGURIMI I AUTOMJETEVE

Bazuar në takimin e fundit të mbajtur në vitin 2013 delegacioni i Kosovës ka mbajtur qëndrimin se zgjidhja më e mirë për zgjidhjen e problemit të çmimeve të larta për sigurim kufitar të automjeteve dhe kufizimet në lirinë e lëvizjes është arritja e një Memorandumi të Mirëkuptimit mes byrove të sigurimeve të Kosovës dhe Serbisë, me lehtësimin dhe garancinë e BE-së. Në disa takime që u mbajtën në vitin 2014 duke filluar nga 16 janari 2014 dhe tutje, pas shumë ideve dhe pozicioneve nga të gjitha palët (duke përfshirë edhe BE-në), ideja mbizotëruese ishte MM-i siç ishte kërkuar nga delegacioni ynë në të gjitha takimet, i cili duhet të hartohet dhe miratohet nga palët.

Është hartuar tashmë një draft pune i MM i cili në esencë mbron parimin se të gjitha automjetet që vijnë nga Kosova do të kenë formularin/kartonin e sigurimit TPL Plus ndërsa automjetet që vijnë nga Serbia do të kenë formularin e sigurimit në bazë të Marrëveshjes Shumëpalëshe të Kartanit të Gjellbër (vetëm sigurimin themelor të lëshuar për automjetet në Serbi) që do t'ju shërbejë për automjetet për të hyrë në Kosovë.

Jemi dakorduar që Këshilli i Byrove (CoB) do të jetë ndërmjetës i marrëveshjes, për të cilin CoB ka dhënë pëlqimin si dhe shumica e çështjeve që kanë të bëjnë me rolin e CoB si ndërmjetëse dhe arbitër janë definuar.

Çështjet që ende mbeten të pazgjidhura janë:

1. Të dy byrotë e sigurimit pajtohen në parim me MM, megjithatë deri më tani ka pasur pengesa nga të dyja, me një sistem të shtytjes dhe tërheqjes, duke mos qenë të qëndrueshme në pozicionet e tyre
2. Çështja e depozitit nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës (dhe kompanive të saj anëtare pjesëmarrëse në marrëveshje) është diskutuar dhe ka një dakordim deri në një masë të caktuar e cila mbetet të finalizohet. Nga CoB-ja është treguar një shkallë e konsiderueshme e fleksibilitetit duke qenë të gatshëm për të ulur shumën e depozitit;
3. Çështja e renditjes së Kosovës në listën e vendeve të përfshira në formularin e sigurimit të Serbisë mbetet për t'u dakorduar
4. Çështja e shumës së dëmeve të paguara palëve në incidentet e automjeteve (vetura, autobus, Kamionë - duke përfshirë edhe transportin e materialeve të rrezikshme)
5. Deri në një masë është zgjidhur çështja e raporteve të policisë, ku në distancë deri 50km raportet duhen të bëhen nga policë që i takojnë përkatësisë së njëjtë etnike me dëshmitarët (kur të aksidentohet një automjet me shofer serb të jetë i pranishëm një

polic serb, dhe kur shoferi është shqiptar i Kosovës një polic shqiptar të jetë i pranishëm në Serbi), megjithatë nevojitet punë shtesë për modalitetet.

Në kontekst të bashkëpunimit dhe integritit të Byrosë së Sigurimit të Kosovës në CoB, që për palën kosovare shihet si një proces i domosdoshëm krahas MM-së me palën serbe mbi çështjen e sigurimit të automjeteve, është diskutuar si në vijim:

Kërkesa nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës që në Kosovë të hapet një pikë e shitjes së Karton të Gjelbër nga ana e ndonjë shteti anëtarë i CoB është parë me mirëkuptim nga ana e CoB. Kjo çështje është e ndarë nga arritja e MM-së, mirëpo do të jetë një hap komplementar që do të mundësojë që qytetarët e Kosovës të kenë mundësi ta blejnë Kartonin e Gjelbërtë në Kosovë para udhëtimit të tyre për vendet e treta.

Po ashtu është diskutuar çështja e kapaciteteve të BSK për të ruajtur pavarësinë e saj financiare në rast të heqjes së sigurimit në kufi (në marrëdhëniet bilaterale midis Zyrës së Sigurimeve të Kosovës dhe CoB.

PËRFUNDIM

Në përgjithësi, Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se ka pasur progres të mirë në dialogun e Brukselit gjatë periudhës raportuese. Progres është bërë në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në të dy dialogjet, dialogun për normalizimin e marrëdhënieve dhe dialogun teknik, duke përfshirë këtu çështjet e funksionimit ligjor dhe demokratik të katër komunave veriore të Kosovës, çështjet e sigurisë për pjesën e policisë, IBM-i, liria e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, librat e regjistrimit civil, e cila është përfunduar, mbledhja të hyrave doganore, të Fondit i zhvillimit, marrëveshjet e zbatimit të energjisë, bashkëpunimi rajonal.

Megjithatë, ka nevojë një progres substancial për të finalizuar planet e zbatimit në çështjet e drejtësisë, ku një pjesë e konsiderueshme të tij është dakorduar tashmë; në çështjet e sigurisë për pjesën e shuarjes së të ashtuquajturës "struktura të mbrojtjes civile serbe"; në telekomunikacion, sigurimin e automjeteve si dhe zhvillimin e planit të zbatimit për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ndërkaq, marrëveshjet për njohjen reciproke të diplomave universitare dhe dokumenteve kadastrale janë në pritje të zbatimit.

Qeveria e Kosovës konsideron se progresi i arritur është i rëndësishëm, megjithatë mbetet shumë më shumë për tu bërë në të ardhmen, për të cilën gjë një vullnet politik i Serbisë për të përmbushur detyrimet është thelbësor.

Dialogu i Brukselit ia arriti të bëjë një përparim në përpjekjet e normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve. Në sajë të lehtësimit konsekuent nga ana e BE-së dhe mbështetjes së plotë nga ana e Shteteve të Bashkuara, marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve me një të kaluar armiqësore janë duke u transformuar në një model evropian të bashkëpunimit.

Lista e shkurtesave

PKK – Pikëkalim Kufitar
DRC - Këshilli Danez për Refugjatë
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
SMC – Strukturat e Mbrojtja Civile
CoB - Këshilli i Zyrave
EEAS - Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
EMS - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut i Serbisë
BE – Bashkimi Evropian
AEU - Asociacioni Evropian i Universiteteve
EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
PSBE – Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PL – Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian
IBM – Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK)
GI – Grupi Implementues
ITU - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
KOSTT - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
PK – Policia e Kosovës
AKVPK - Agjencia Kosovare e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës e
MARRI - Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MM - Memorandum i Mirëkuptimit
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KM – Kryeministrat
RECIVAC - Qendra për Bashkëpunim në Siguri
KBR - Këshilli i Bashkëpunimi Rajonal

ReSPA - Shkolla Rajonale e Administratës Publike

SEECF - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore

SELEC - Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore